



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi i Kosovës/Skupstina Kosova/Assembly of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



RAPORTI MBI AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË PËR VITIN 2009

01 janar 2009 - 31 dhjetor 2009

**Shkurt 2010
Prishtinë**

P Ë R M B A J T J A

HYRJE	3
1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.....	4
2. Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë gjatë vitit 2009	5
2.1. Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009.....	6
2.2. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009	7
2.3. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas burimeve të financimit.....	9
2.4. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas llojit të prokurimit.....	11
2.5. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas vlerës së prokurimit.....	13
2.6. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas procedurave të prokurimit.....	15
2.7. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas llojit dhe procedurave të prokurimit.....	17
2.8. Prokurimet Publike sipas vlerës së përlllogaritur dhe vlerës së kontratës së nënshkruar gjatë vitit 2009	18
2.9. Kontratat e nënshkruara dhe anekskontratat gjatë vitit 2009.....	18
2.10. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas operatorëve ekonomik.....	19
2.11. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas afatit kohor për publikim.....	21
2.12. Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 sipas kriterëve për dhënie.....	23
2.13. Prokurimet publike në raport me BPV në Kosovë gjatë vitit 2009.....	22
2.14. Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara në Kosovë nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit.....	23
2.15. Autoritetet kontraktuese me vlerë të përgjithshme të kontratave të nënshkruara që e tejkalojnë vlerën 4.000.000,00 gjatë vitit 2009.....	27
2.16. Kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 3.000.000,00 nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2009.....	28
3. Aktivitetet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.....	30
4. Rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.....	36
5. Aneks: Shpenzimet Buxhetore të KRPP-së për vitin 2009	38

H Y R J E

Duke u bazuar në Nenin 82.2 (i), të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, nr. 02/L-99, të shpallur me Rregulloren nr. 2007/20, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik përgatit dhe ia dorëzon Qeverisë e Kuvendit të Kosovës Raportin vjetor, në të cilin i analizohen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë, për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe përmirësimin e Ligjit për Prokurim Publik sipas nevojës. Ky raport duhet t'i dërgohet Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës më së voni deri në fund të muajit shkurt të vitit vijues.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke u bazuar në kërkesën e nenit të lartshënuar të Ligjit për Prokurim Publik, me kohë e ka përgatitur Raportin vjetor për vitin 2009 dhe ua dërgon Qeverisë së Kosovës si dhe Kuvendit të Kosovës.

Ky raport është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik nr. 02/L-99, duke paraqitur një analizë mjaft të detajuar mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara në Kosovë, sipas kontratave të nënshkruara publike gjatë periudhës 1 janar 2009 - 31 dhjetor 2009.

Përgatitja e këtij raporti përmbush edhe kërkesën e Nenit 82.2 (h) të Ligjit për Prokurim Publik, sipas të cilit KRPP-ja duhet t'i grumbullojë, t'i analizojë dhe t'i publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat e dhëna publike.

Është ky viti i pestë me radhë që KRPP-ja përgatit një raport të tillë, duke u munduar që për çdo vit ta avancojë dhe ta kompletojë atë sa më shumë që të jetë e mundur, me qëllim që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, ta kenë një pasqyrë të plotë mbi të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë të zhvilluara gjatë vitit 2009.

Ky raport do të jetë mjaft i mirëseardhur edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktiviteteve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit. Raporti do të jetë i dobishëm edhe për donatorët e ndryshëm që mendojnë të investojnë në të ardhmen në Kosovë, pasi që, duke u bazuar në të dhënat e raportit, mund të konstatohet se 84.86 % e buxhetit për prokurime publike në Kosovë gjatë vitit 2009 janë shpenzuar përmes procedurës së hapur, që njihet si procedura më transparente në prokurimin publik.

1. KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i Kosovës është themeluar duke u bazuar në nenin e 81-të të Ligjit për Prokurim Publik, nr. 2003/17, i cili ka hyrë në fuqi më 9 qershor të vitit 2004. KRPP-ja ka filluar të funksionojë më 3 shkurt të vitit 2005. Me amendamentimin e Ligjit për Prokurim Publik, nga ana e Kuvendit të Kosovës, më 8 shkurt të vitit 2007, të shpallur me Rregulloren nr. 2007/20 më 6 qershor të vitit 2007, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ndryshojnë duke iu përshtatur kërkesave që dalin nga dy Direktivat e Prokurimit të BE-së, nr. 2004/17 dhe 2004/18, si dhe rrethanat që janë krijuar në Kosovë në fushën e prokurimit publik gjatë periudhës 2004-2007.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, nr. 02-L/99, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik :

- Është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë;
- Vendos rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së;
- Nxjerr dhe publikon interpretime me shkrim, si dhe ofron ndihmë teknike e këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë për zbatimin e dispozitave të LPP-së;
- Krijon dhe mirëmban faqen informative në internet, e cila i ofron publikut qasje të pakufizuar në të dhënat mbi prokurimin publik në Kosovë, si dhe mundëson përmirësimin e publikimeve të kërkuara sipas LPP-së;
- Mbështet IKAP-in dhe autoritetet e tjera publike të trajnimit dhe arsimimit për të siguruar trajnimin dhe aftësimin e zyrtarëve të prokurimit publik në tërë Kosovën;
- Fillon dhe mbështet zhvillimin e prokurimit elektronik dhe komunikimin brenda fushës së prokurimit publik;
- Grumbullon, analizon dhe publikon informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe të gjitha kontratat publike të dhëna në Kosovë;
- Bashkëpunon me organizatat e tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik;
- Ia propozon Qeverisë dhe Kuvendit masat për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe përmirësimin e këtij ligji.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik udhëhiqet nga Bordi, që përbëhet prej pesë anëtarëve, të cilët propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Me amendamentimet e bëra në LPP parashihet që në ardhmen Bordi i KRPP-së t'i ketë 3 anëtarë të përhershëm, kurse çdo anëtar i KRPP-së, i cili është në detyrë që prej 31 dhjetorit 2006, do të vazhdojë të shërbejë në atë detyrë deri në mbarimin e mandatit të tij, siç parashikohet në legjislacionin e prokurimit që ishte në fuqi në kohën e emërimit të tij.

2. AKTIVITETET E PROKURIMIT PUBLIK NË KOSOVË GJATË VITIT 2009

Duke u bazuar në Nenin 82.2. (n) të Ligjit për Prokurim Publik, nr. 02-L/99, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të përgatisë dhe të mbajë një listë të plotë të gjitha autoriteteve kontraktuese në Kosovë, të cilat janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Prokurim Publik. Më 1 janar 2009 në Kosovë kanë ekzistuar 142 autoritete kontraktuese, kurse më 31 dhjetor 2009 numri i këtyre autoriteteve kontraktuese është shtuar në 152.

Përmes raporteve vjetore për kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2010, i kanë dërguar në mënyrë elektronike, Departamenti i TI-së ka përgatitur Raportin përmbledhës vjetor për të gjitha prokurimet publike të zhvilluara në Kosovë gjatë vitit 2009.

Nga gjithsej 152 autoritete kontraktuese sa kanë ekzistuar në Kosovë në fund të vitit 2009, 149 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet vjetore, 3 autoritete kontraktuese fare nuk i kanë dërguar raportet vjetore. Autoritetet kontraktuese, të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet vjetore, janë vetëm tri komuna nga pjesa veriore e Kosovës - Komuna e Zveqanit, e Zubin Potokut dhe e Leposaviqit. Buxheti i paraparë të shpenzohet për prokurime për këto tri komuna, sipas BKK-së, gjatë vitit 2009 është 2.334.220 €, e që marrin pjesë vetëm me 0,30% në vlerën gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara publike për vitin 2009.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2009 në tërë Kosovën janë nënshkruar 14 820 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të prokurimit.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kriterëve të shpërblyer me kontratë.


Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2009 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitin paraprak, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të aktivitetëve të prokurimit të zhvilluara në Kosovë.

2.1. NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009

Numri i kontratave të nënshkruara				
Autoritetet kontraktuese:	Numri i kontratave 2007	Numri i kontratave 2008	Numri i kontratave 2009 ¹	Krahasimi i vitit 2008/2009 (%)
Qeveritare	10622	10882	10955	0.67
Kompani publike	4578	3431	3786	10.35
Tjera	18	4	79	1875.00
Gjithsej:	15218	14317	14820	3.51

Tabela 1

Analizën e kontratave të nënshkruara po e fillojmë me ndarjen e autoriteteve kontraktuese në organizata buxhetore – qeveritare, kompani publike dhe të tjera-OJQ. Dihet mirëfilli se kjo ndarje nuk e paraqet një pasqyrë reale të financimit, pasi që një numër i konsiderueshëm i kompanive publike në Kosovë financohen ende nga BKK-ja. Sido që të jetë, ne do të mundohemi, duke u bazuar në këtë ndarje, ta pasqyrojmë numrin e kontratave të nënshkruara në tabelën nr. 1 dhe në grafikun nr. 1 gjatë tre vjetëve të fundit nga autoritetet kontraktuese në fjalë.



Grafikoni 1

¹⁾ Në numrin e kontratave të nënshkruara janë përfshirë edhe 256 anekskontrata.

Duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, autoritetet kontraktuese janë të obliguara t'i paraqesin të gjitha kontratat e nënshkruara, duke përfshirë edhe ato me vlerë minimale.

Numri i përgjithshëm i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 është 14820, e që krahasuar me vitin paraprak paraqet një rritje të numrit të tyre prej 3.51 %.

2.2. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009


Vlera e kontratave të nënshkruara (€)				
Autoritetet kontraktuese:	Vlera e kontratave 2007	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009 ²	Krahasimi i vitit 2008-2009 (%)
Qeveritare	187,463,647.57	456,695,720.32	529,849,302.73	16.02
Kompani publike ³	213,824,064.35	369,627,159.60	245,382,175.36	-33.61
Tjera	940,724.98	160,682.75	2,922,036.94	1718.51
Gjithsej :	402,228,436.90	826,483,562.67	778,153,515.03	-5.85

Tabela 2

Në bazë të klasifikimit të autoriteteve kontraktuese, si më lart në tabelën nr.2 dhe grafikun nr. 2, po paraqesim vlerën e kontratave të nënshkruara, gjatë tre vjetëve të fundit. Duke e krahasuar vlerën totale të kontratave të nënshkruara me vitet paraprake, kemi një rritje të vazhdueshme të organizatave buxhetore - qeveritare, derisa të kompanitë publike vlera e kontratave të nënshkruara, krahasuar me vitet paraprake, paraqitet e zvogëluar, pasi që në vlerën e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2008 të kompanitë publike kanë ndikuar kontratat e nënshkruara afatgjate nga ana e KEK-ut.

² Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera prej 8, 387, 328.16 e anekskontratave

³ Në zvogëlimin e vlerës së kontratave të nënshkruara të kompanitë publike prej 33.61 % gjatë vitit 2009, në krahasim me vitin 2008, kanë ndikuar kontratat e nënshkruara nga kompanitë publike, e sidomos kontratat e nënshkruara afatgjate nga ana e KEK-ut gjatë vitit 2008.



Grafikoni 2

Grafikoni nr. 3 e pasqyron strukturën, apo pjesëmarrjen e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009. Organizatat buxhetore - qeveritare marrin pjesë me 68.09%, kompanitë publike me 31.53%, derisa te autoritetet tjera – OJQ-të me vetëm 0.38% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara.




Grafikoni 3

2.3. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit (€)				
Burimet e financimit:	Vlera e kontratave 2007	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Krahasimi 2008/2009 (%)
Të hyrat vetjake ⁴	145,812,848.23	145,264,989.52	178,936,718.11	23.18
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	250,156,142.79	676,563,199.06	586,539,985.28	-13.31
Donacione	6,259,445.88	4,655,374.09	12,676,811.64	172.30
Gjithsej :	402,228,436.90	826,483,562.67	778,153,515.03	-5.85

Tabela 3

Në tabelën nr.3 dhe grafikun nr.4 është pasqyruar vlera e kontratave të nënshkruara, duke pasur për bazë burimin e financimit. Nga të hyrat vetjake vlera e kontratave të nënshkruara është 178,936,718.11€, krahasuar me vitin paraprak shënohet një rritje prej 23.18%. Nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës vlera e kontratave të nënshkruara arrin 586,539,985.28 €, gjë që krahasuar me vitin paraprak paraqitet një zvogëlim prej 13.31 %, derisa nga donacionet vlera e kontratave të nënshkruara arrin 12,676,811.64 € dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 172.30 %.



Grafikoni 4

⁴ Të hyrat vetjake paraqesin të hyrat e kompanive publike.

Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit pasqyrohet në grafikun nr. 5, ku të hyrat vetjake marrin pjesë me 23.00%, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me 75.38 %, kurse nga donacionet me 1.63 %.




Grafikoni 5

2.4. VLERA E KONTRATAVE TË NËNShKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS LLOJIT TË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas llojit të prokurimit (€)				
Lloji i prokurimit:	Vlera e kontratave 2007	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Krahasimi 2008/200 (%)
Furnizim	242,642,818.13	334,982,809.59	289,392,796.00	-13.61
Shërbime ⁵	29,501,718.56	44,243,562.12	62,266,651.91	40.74
Konkurs i projektimit	4,247,904.02	845,583.04	1,667,506.79	97.20
Punë	125,835,996.19	446,411,607.92	424,806,560.33	-4.84
Gjithsej :	402,228,436.90	826,483,562.67	778,133,515.03	-5.85

Tabela 4


Bazuar në llojin e prokurimit, që kontratat kanë si objekt të tyre, në tabelën nr. 4 dhe grafikun nr. 6, vlera e kontratave të nënshkruara për furnizime arrin në 289,392,796.00 €, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim prej 13.61%. Vlera e kontratave të nënshkruara për shërbime është 62,266,651.91 €, kurse krahasuar me vitin paraprak kemi rritje prej 40.74%, gjë që paraqet trendin e njëjtë të rritjes me vitet paraprake, pasi që nevoja për lloje të shërbimeve të ndryshme profesionale në vendin tonë shtohet nga dita në ditë, në varësi nga trendi i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik.



Grafikoni 6

⁵ Në vlerën e kontratave për shërbime janë përfshirë edhe shërbimet e konsulencës.

Vlera e kontratave të nënshkruara për konkurs projektimi është 1,667,506.79€, krahasuar me vitin paraprak kemi rritje prej 97.20%, ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara për punë arrin në 424,806,560.33€, krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim 4.84%, pra ky lloj i kontratave mbetet edhe më tej në trendin e njëjtë të pjesëmarrjes në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara.



Grafikoni 7


Grafikoni nr 7, paraqet strukturën, apo pjesëmarrjen e kontratave të nënshkruara, sipas vlerës në totalin e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009. Kontratat për furnizime marrin pjesë me 37.19%, duke shënuar një zvogëlim në vlerën e tërësishme të kontratave të nënshkruara, krahasuar pra me vitin paraprak, gjë që paraqet një trend mjaft pozitiv duke lënë të kuptohet se furnizimet e ndryshme janë duke u zvogëluar dhe duke u zëvendësuar me investime kapitale dhe me shërbime profesionale. Kontratat për shërbime me 8.00%, kontratat për konkurse të projektimit me 0,21%, ndërsa kontratat për punë marrin pjesë me 54.60%, që shënon një rritje të lehtë, e cila pjesëmarrje vitin paraprak ishte 54,01%.

2.5. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS VLERËS SË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas vlerës së prokurimit (€)				
Lloji i vlerës së prokurimit:	Vlera e kontratave 2007	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009 ⁶	Krahasim 2008/2009 (%)
Vlerë e madhe	286,532,415.11	680,198,284.54	575,602,784.31	-15.38
Vlerë e mesme	89,841,042.31	119,156,951.86	171,592,255.32	44.01
Vlerë e vogël	22,826,536.65	23,599,031.30	27,080,232.79	14.75
Vlerë minimale	3,028,442.83	3,529,294.97	3,878,242.61	9.89
Gjithsej :	402,228,436.90	826,483,562.67	778,153,515.03	-5.85

Tabela 5

Kontratat e nënshkruara, të ndara sipas llojit të vlerave të kontratave, në tabelën nr. 5 dhe në grafikonin nr. 8, na pasqyrojnë se, sipas vlerës së madhe, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 është 575,602,784.31 €, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim prej 15.38%.




Grafikoni 8

⁶ Në vlerën e kontratave të nënshkruara është përfshirë edhe vlera prej 8,387, 328.16€ e aneks kontratave.

Kontratat e nënshkruara me vlerë të mesme arrijnë shumën prej 171,592,255.32 €, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 44.01%, vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë të vogël është 27,080,232.79€, kurse në krahasim me vitin paraprak kemi rritje prej 14.75%. Vlera e kontratave të nënshkruara me vlerë minimale është 3,878,242.61€, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 9.89%.

**Struktura e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009
sipas llojit të vlerës së prokurimit**



Grafikoni 9

Në bazë të grafikonit nr. 9 vërehet se pjesëmarrja e kontratave me vlera të mëdha, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009, është 73.97%. Kontratat me vlera të mesme marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 22.05%. Kontratat me vlerë të vogël marrin pjesë në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara me 3.48%, derisa kontratat me vlerë minimale marrin pjesë me 0,50 %.

2.6. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit (€)				
Lloji i procedurave:	Vlera e kontratave 2007	Vlera e kontratave 2008	Vlera e kontratave 2009	Krahasimi 2008/2000 (%)
Procedurë e hapur	326,326,955.34	639,679,203.78	660,305,834.65	3.22
Procedurë e kufizuar	1,772,982.62	0.00	0.00	0.00
Konkurs projektimi	180,660.54	845,583.04	1,687,506.79	99.57
Procedurë e negociuar ⁷	50,153,766.34	164,156,690.61	87,263,076.82	-46.84
Kuotimi i çmimeve	20,765,629.23	18,288,457.42	25,078,675.39	37.13
Procedurë për vlerë minimale	3,028,442.83	3,513,627.82	3,818,421.38	8.67
Gjithsej :	402,228,436.90	826,483,562.67	778,153,515.03	-5.85


Tabela 6

Analiza e kontratave të nënshkruara, të ndara sipas llojit të procedurave në tabelën nr. 6 dhe në grafikonin nr.10, tregon se vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së hapur gjatë vitit 2009 është 660,305,834.65 € dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 3.22%. Sipas procedurës së kufizuar gjatë vitit 2009 autoritetet kontraktuese nuk kanë paraqitur prokurime.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës konkurs projektimi, gjatë vitit 2009, është 1,687,506.79€, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 99.57%. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës së negociuar, gjatë vitit 2009, është 87,263,076.82€, krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim prej 46.84%, pra kemi një trend mjaft pozitiv sa i përket përdorimit të kësaj procedure gjatë vitit 2009. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas procedurës kuotim i çmimeve, gjatë vitit 2009, është 25,078,675.39€, gjegjësisht 37.13 % e shtuar krahasuar me vitin paraprak.


Ndërkaq, sipas procedurës për vlerë minimale, vlera e kontratave të nënshkruara, gjatë vitit 2009, është 3,818,421.38€ dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 8.67 %, por trend pothuajse të njëjtë të vlerës së këtyre kontratave të nënshkruara, apo parave të shpenzuara sipas kësaj procedure gjatë këtyre tre vjetëve, ndaj dyfishimit të buxhetit gjatë dy vjetëve të fundit, krahasuar me vitin 2007, është mjaft pozitiv, sepse kjo vlerë e kontratave, sipas kësaj procedure, nuk ka shënuar rritje në raport me buxhetin.

⁷ Procedura e negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës = 3,027,620.00 ; Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës = 84,235,456.82



Grafikoni 10

Analiza e strukturës, apo e pjesëmarrjes së procedurave të zbatuara gjatë vitit 2009, në grafikonin nr. 11, na pasqyron se pjesëmarrja e procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara për vitin 2009 është 84.86%, duke shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak që ishte 77.40%. Trendi në rritje i pjesëmarrjes së kësaj procedure është mjaft pozitiv, pasi që procedura e hapur është ndër procedurat më transparente.



Grafikoni 11

Gjithashtu, edhe pjesëmarrja e procedurës së negociuar është 11.21%, e cila ka një zvogëlim të theksuar ndaj vitit paraprak, kur ishte 19,86%. Trendi në zvogëlim i pjesëmarrjes së vlerës së kësaj procedure, në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009, gjithashtu është mjaft pozitiv.

Derisa pjesëmarrja e procedurave sipas koutimit të çmimeve është 3.22% dhe sipas vlerës minimale merr pjesë me 0,49 %, kurse konkurset e projektimit marrin pjesë vetëm me 0,22 % në vlerën e kontratave të gjithëmbarshme të nënshkruara gjatë vitit 2009.


Prandaj, mund të konstatojmë se përdorimi i procedurës së hapur dhe rritja në vazhdim e saj, si edhe zvogëlimi i përdorimit të procedurës së negociuar, janë indikatorë mjaftë shpresëdhënës për prokurimin publik, për ekonominë kosovare dhe të ardhmen e saj drejt BE-së.

2.7. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS LLOJIT DHE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas llojit dhe procedurave të prokurimit							
Lloji prokurimit	E hapur	Kufi zuar	Konkurs projektimi	E negociuar	Kuotim i çmimeve	Vlera minimale	Gjithsej:
Furnizim	209,031,918.37	-	-	60,823,137.40	16,562,187.27	2,975,552.96	289,392,796.00
Shërbime	36,600,111.49	-	-	16,740,783.33	8,090,825.41	834,931.68	62,266,651.91
Konkurs projektim	-	-	1,687,506.79	-	-	-	1,687,506.79
Punë	414,673,804.79	-	-	9,699,156.09	425,662.71	7,936.74	424,806,560.33
Gjithsej	660,305,834.65	-	1,687,506.79	87,263,076.82	25,078,675.39	3,818,421.38	778,153,515.03

Tabela 7

Në tabelën nr. 7 dhe grafikun nr. 12 kemi të pasqyruar vlerën e kontratave të nënshkruara sipas llojit dhe ndërthurjen e tyre me vlera të kontratave sipas procedurave të prokurimit gjatë vitit 2009. Këtu, pra, pasqyrohet secili lloj i prokurimit ndaj procedurës së zbatuar të prokurimit.



Grafikoni 12

2.8. KONTRATAT E NËNSHKRUARA SIPAS VLERËS SË PËRLLOGARITUR DHE VLERËS SË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR GJATË VITIT 2009

Kursimet e realizuara nga prokurimet gjatë viteve 2007, 2008 dhe 2009 (€)			
	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009
Numri i kontratave të nënshkruara:	15218	14317	14820
Vlera e kontratave të planifikuar	435,952,876.73	900,203,954.31	804,131,958.14
Vlera e kontratave të nënshkruara	402,228,436.90	826,483,562.67	778,153,515.03
Kursimet (€)	33,724,439.83	73,720,391.64	25,978,443.11
Kursimet (%)	8.38	8.92	3.34

Tabela 8

Në bazë të kërkesave, sipas Nenit 8.2 të LPP-së, çdo autoritet kontraktues para se ta fillojë aktivitetin e prokurimit duhet të sigurohet që mjetet për atë aktivitet të prokurimit të jenë siguruar, duke u bazuar në vlerën parallogaritare të projektit përkatës. Nga tabela nr. 8 shihet se vlera parallogaritare për të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2009 ka qenë 804,131,958.14 €, ndërsa vlera sipas kontratave të nënshkruara ka qenë 778,153,515.03 €. Kursimet e buxhetit në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2009 janë 25,978,443.11 €, apo shprehur në përqindje kemi një kursim të buxhetit për 3.34%. Kjo vjen si rezultat i zbatimit të procedurave të hapura gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit, duke marrë parasysh se 84.86% të buxhetit për prokurime gjatë vitit 2009, janë shpenzuar sipas procedurave të hapura, e që janë procedurat më transparente sipas kërkesave të LPP-së.

2.9. KONTRATAT E NËNSHKRUARA DHE ANEKSKONTRATAT GJATË VITIT 2009

Vlera e kontratave të nënshkruara dhe anekskontratave gjatë vitit 2009 (€)				
Kontratat:	Numri i kontratave 2009	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2009	Pjesëmarrja %
Kontratat e nënshkruara	14564	98.27	769,766,186.87	98.92
Anekskontratat	256	1.73	8,387,328.16	1.08
Gjithsej :	14820	100.00	778,153,515.03	100.00

Tabela 9


Siç shihet nga tabela e mësipërme nr.9, vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 është 769,766,186.87 €, me një pjesëmarrje prej 98.92% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara, kurse vlera e anekskontratave arrin në 8,387,328.16 €, apo me pjesëmarrje 1.08% në vlerën e gjithëmbarshme të kontratave të nënshkruara e që është 778,153,515.03€ .

2.10. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS OPERATORËVE EKONOMIK VENDOR DHE JOVENDOR

Vlera e kontratave të nënshkruara OE vendorë – jovendorë gjatë vitit 2009 (€)				
Operatorët ekonomik:	Numri i kontratave 2009	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2009	Pjesëmarrja %
Operatorët vendor	14614	98.610	665,339,300.79	85.50
Operatorët jovendor	206	1.390	112,814,214.24	14.50
Gjithsej :	14820	100.000	778,153,515.03	100.00

Tabela 10

Nga analiza e bërë e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009, të ndara sipas shpërblimit me kontratë në operator ekonomik vendor dhe jovendor, në tabelën 10, grafikonin 13, del se vlera e kontratave të dhëna operatorëve vendor është 665,339,300.79 €, kurse pjesëmarrja në vlerën e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 është 85.50%. Derisa vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009 nga operatorët jovendor është 112,814,214.24€ dhe me pjesëmarrje prej 14.50% në strukturën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009.



Grafikoni 13

2.11. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS AFATIT KOHOR PËR PUBLIKIM

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor të publikimit gjatë vitit 2009 (€)				
Afatet e publikimit:	Vlera e kontratave 2008	Pjesëmarrja %	Vlera e kontratave 2009	Pjesëmarrja %
Afate normale kohore	496,290,782.15	60.05	587,807,910.50	75.54
Shkurtim i afatit	330,192,780.52	39.95	190,345,604.53	24.46
Gjithsej :	826,483,562.67	100.00	778,153,515.03	100.00

Tabela 11

Të dhënat në tabelën nr. 11, vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese me afate normale kohore është 587,807,910.50 € dhe me pjesëmarrje prej 75.54 % në vlerën e gjithëmbarshtë të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009. Kurse vlera e kontratave të nënshkruara të publikuara me afat të shkurtuar arrin në 190,345,604.53€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 24.46% në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009.

2.12. VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2009 SIPAS KRITERIT PËR DHËNIE KONTRATE

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie gjatë vitit 2009 (€)				
Kriteret për dhënie kontrate:	Vlera e kontratave 2008	Pjesëmarrja (%)	Vlera e kontratave 2009	Pjesëmarrja (%)
Çmimi më i ulët	465,130,664.48	56.28	420,712,646.21	54.07
Çmimi ekonomikisht më i favorshëm	361,352,898.19	43.72	357,440,868.82	45.93
Gjithsej :	826,483,562.67	100.00	778,153,515.03	100.00

Tabela 12

Siç shihet në tabelën nr. 12 vlera e kontratave të nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, sipas kriterit për dhënie çmimi më i ulët, është 420,712,646.21€, me pjesëmarrje prej 54.07 % në vlerën e gjithëmbarshtë të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009. Ndërkaq, vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie çmimi ekonomikisht më të favorshëm arrin në 357,440,868.82€, gjegjësisht me pjesëmarrje prej 45.93 % në numrin e përgjithshëm të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2009.

2.13. PROKURIMET PUBLIKE NË RAPORT ME BPV NË KOSOVË GJATË VITIT 2009

Vlera e përgjithshme e prokurimeve publike, të evidentuara në bazë të raporteve të dërguara nga autoritetet kontraktuese, që përfshin numrin prej 14 820 kontratave të nënshkruara për periudhën 1.1.2009 - 31.12.2009, është 778,153,515.03 €, gjë që paraqet 19,86 % të BPV (bruto produkti vendor në vitin 2009 në Kosovë = 3,918,000,000.00 €.)⁸



Grafikoni 14

⁸ Burimi : Departamenti i Makroekonomisë - MEF

2.14. NUMRI DHE VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA NË KOSOVË NGA AUTORITETET KONTRAKTUESE GJATË VITIT 2009

	Autoritetet Kontraktuese	Nr i kontratave ⁹	Vlera e kontratave (€)	Pjesëmarrja (%)
1	Administrata Tatimore e Kosovës	58	1,140,474.11	0.15
2	Aeroporti	198	9,577,056.96	1.23
3	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	20	275,128.40	0.04
4	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	100	1,260,076.38	0.16
5	Agjencia Kadastrale e Kosovës	16	50,404.79	0.01
6	Agjencia Kosovare e Privatizimit	69	1,253,081.74	0.16
7	Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM	7	26,106.30	0.00
8	Agjencia Pyjore e Kosovës	24	444,101.90	0.06
9	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	21	22,424.96	0.00
10	Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale	17	362,266.36	0.05
11	Agjencia e Prokurimit Publik	20	887,408.59	0.11
12	Agjencia Kosovare e Pronës	93	621,353.69	0.08
13	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit	38	156,930.83	0.02
14	Akademia e Shkencave dhe Arteve	36	81,647.60	0.01
15	Autoriteti i Aviacionit Civil	15	47,105.62	0.01
16	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit	18	127,818.92	0.02
17	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	92	1,275,816.85	0.16
18	Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës	49	117,011.03	0.02
19	CDF	10	1,378,292.58	0.18
20	Dogana	103	2,249,695.50	0.29
21	Drini i Bardhe Pejë	1	650.00	0.00
22	Enti Statistikor	10	183,964.45	0.02
23	Enti për Ndihmë të Shpejtë Mjekësore	18	22,273.00	0.00
24	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	26	74,176.87	0.01
25	Hekurudhat e Kosovës	206	6,905,605.12	0.89
26	Inspektorati Policor i Kosovës	28	156,554.66	0.02
27	Ombudspersoni	74	115,241.83	0.01
28	Instituti Albanologjik	8	55,209.61	0.01
29	Instituti Gjyqësor i Kosovës	28	220,038.98	0.03
30	IKAP	9	15,251.70	0.00
31	Instituti i Mjekësisë Punës Gjakovë	23	271,998.04	0.03
32	Instituti Kombëtar i Sh. Publik i Kosovës	33	977,956.94	0.13
33	Instituti Kombëtar i Sh. Publik Ferizaj	3	2,324.68	0.00
